




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa:rr."Adem Jashari" pn, kk.rks-gov.net/gjilan, info.gjilan@rks-gov.net tel.0280 320 781, 0280 320 782, 321 482, 321 483

Duke u bazuar në nenin 5, 11 dhe 12 pika (d) e Ligjit nr.03/L-40 Për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 11, paragrafi 2, nenin 43 dhe 45 paragrafi 2 i Ligjit mbi Tokën Ndërtimore (Gazeta Zyrtare e Kosovës nr.14/80 dhe 42/86), nenin 4 dhe 5 paragrafi 1, 2, 5 dhe 6 i Ligjit Nr.03/L-226 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenin 38 pika 1.2 dhe 1.3 të Statutit të Komunës së Gjilanit, në harmoni me Planin e Plotësuar Rregullues Urban "Fidanishte", me Rekomandimin e Komitetit për Pronë, Kadastër dhe Banim të dt.18.06.2012, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në seancën e mbajtur me datë 29.06.2012, miraton këtë :

V E N D I M

Për Aprovimin e Marrëveshjes Parimore Nr.02-373 të dt.05.06.2012 për kompletimin e ngastrave ndërtimore përmes ndërrimit të kufijve të parcelave dhe rregullimit të marrëdhënjeve reciproke pronësoro-juridike, Zona Fidanishte

I.

Me këtë Vendim, Komuna e Gjilanit e Aprovon Marrëveshjen e lidhur ndërmjet Kryetarit të Komunës dhe Ndërmarrjes "Kosova-Komerc" Sh.P.K nga Gjilani, për kompletimin e ngastrave ndërtimore përmes ndërrimit të kufijve të parcelave me qëllim të implementimit të Planit të Plotësuar Rregullues Urban "Fidanishte" i aprovuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Gjilanit nr.01-16/7083 të datës 30.05.2011.

II.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi do të jetë Marrëveshja Nr.02-373 e dt.05.06.2012 kurse e nënshkruar me dt.04.06.2012.

III.

Ngastra kadastrale e krijuar pas zbatimit të kësaj marrëveshje, me sipërfaqe prej 14369 m², e cila do të regjistrohet në emër të Kuvendit Komunal të Gjilanit, i ipet në shfrytëzim Qendrës Edukativo - Sociale "Don Bosko", me qëllim të implementimit të projektit zhvillimor si : ndërtimi i një Shkolle Profesionale, e cila do të bashkëpunon me Drejtorinë e Arsimit të Komunës së Gjilanit si dhe do t'i plotësoj nevojat e profesioneve që do t'i paraqesë komuna; ndërtimi i një konvikti për nxënës, një sallë teatri dhe qendër kulturore, salla sportive të mbyllura dhe terene të hapura si dhe një Qendër Rinore. Kushtete dhe mënyra e shfrytëzimit të kësaj ngastare nga ana e Qendrës Edukativo - Sociale "Don Bosko" do të rregullohen me kontratë të veqanët me Komunën e Gjilanit në harmoni me dispozitat ligjore.

IV.

Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, me qëllim të zbatimit të kësaj marrëveshje të bënë parcelimin e ngastrave në fjalë dhe regjistrimin e këtyre ndërrimeve në librat kadastral.

V.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Gjilanit, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e KK-Gjilan, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i Kuvendit Komunal Gjilan.

VI.

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

Nr.01.16-69763
Gjilan, më 29.06.2012

Kuvendi i Komunës
Izmi ZEKA, Kryesues